



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER**

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit nr. 243 datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”i ndryshuar, Bashkia Fier shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

- **1 (një) Specialist në Sektorin e Pyjeve, ne Drejtorine e Pyjeve dhe Mjedisit**

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele.

Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton vakant, atëherë është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë.

Afati për dorëzimin e dokumentave për LEVIZJE PARALELE: 02.12.2025

Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL: 07.12.2025

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Bën përditësimin e kadastrës së fondit pyjor dhe kullësor për çdo vit dhe në fillim të çdo viti pasardhës në bazë të dokumentacionit teknik e ligjor të arkivuar në drejtori.
- Ndjek dhe realizon edhe me grup pune të gjitha llojet e inventarizimeve si për pyjet, bimët mjekesore e tanifere, gjuetisë etj., brenda territorit që mbulon, konform kërkesave ligjore dhe udhëzimeve përkatëse të Ministrit.
- Bën matjet në terren të të gjitha ndryshimeve që ndodhin në fondin pyjor, bën ndryshimet përkatëse në kadastrë si për pakësimin ashtu dhe për shtesat e tij si dhe, përpilon dokumentacionin përkatës për këto ndryshime kadastrale dhe raportohen sipas instancave.
- Bën ndryshimet kadastrale për heqjet nga fondi pyjor dhe kullësor.
- Kontrollon dhe bën matjet për rruget auto pyjore që hapen me miratim nga subjekte të ndryshme si dhe bën pakësimin e fondit pyjor për këto raste.
- Konform akteve ligjore dhe nënligjore si dhe brenda normativave të lejuara, mban dhe administron fondin e dokumentacionit teknik që disponohet nga kjo drejtori.
- Përgjigjet për administrimin tërësor të fondit pyjor kombëtar, publik e privat, brenda kufijve administrativë të bashkisë;
- Ngrenë dhe mirëmban regjistrin (Kadastrën) e fondit pyjor kombëtar në bashki. Mbledh të dhëna për zhvillimin e pyjeve publike dhe private, përgjigjet për ruajtjen e ekuilibrit biologjik në

fondin pyjor vendor dhe mban të dhëna të sëmundjeve, të dëmtuesve dhe të zjarreve në pyjet e bashkisë e ato private, brenda territorit administrativ të bashkisë;

- Harton, zbaton dhe kontrollon ecurinë sipas planeve operacionale, në përputhje me dokumentet e planifikimit strategjik dhe planet e mbarështimit, për fondin pyjor publik e privat, brenda territorit administrativ të bashkisë, duke bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse për mjedisin, si dhe administron të gjithë dokumentacionin përkatës;
- Kryen studimin e njësive ekonomike pyjore të cilat do të vihen në shfrytëzim sipas të dhënave të Planit të Mbarështimit në përputhje me përcaktuesit kryesore siç është; “mundësia vjetore e shfrytëzimit” si dhe, përcakton kriteret dhe skemat e detyrueshme teknologjike të prodhimit.
- Organizon dhe merr pjesë në komisionet e ankandeve të ngritura për shitjen e lëndës drusore dhe prodhimeve të tjera pyjore.
- Merr pjesë në procesin e damkimeve për shfrytëzimet që do të bëhen sipas periudhave, kontrollon llogaritjet e list- damkave, përmbledheset, etj konform rregullores së shfrytëzimit, për ti patur të gatshme si gjatë zhvillimit të ankandit ashtu dhe për t’jua dorëzuar subjekteve.
- Harton dhe mban evidenca, raporte dhe të dhëna statistikore për sektorin që mbulon dhe i vendos ato në dispozicion të strukturave drejtuese dhe koordinuese, në funksion të raportimit të punës.
- Evidenton nevojat për investime në pyje dhe kullota me qëllimin e ruajtjes dhe përmirësimit të kapaciteteve të tyre shfrytëzuese.
- Evidenton probleme që dalin nga veprimtaria e përditëshme si dhe shqetësimet e ndryshme që ngrihen me shkrim nga qytetarët, përcakton zgjidhjet e mundshme brenda kuadrit ligjor në fuqi.
- Bashkëpunon për përmbushjen e objektivave dhe zbaton detyrat që i ngarkohen nga përgjegjësi i sektorit dhe drejtorit të drejtorisë.

1. LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- b. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c. Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mire”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

Të zotërojnë nivelin minimal të diplomës “Master Profesional” në një nga degët e Fakultetit të Inxhinierisë së Mjedisit, Pyjeve

Të kenë të paktën 1 vit përvojë pune në administratën shtetërore vendore

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Korçë, dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip
- b- Fotokopje e notërizuar e diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

- h- Aktin e emërimit në shërbimin civil;
- i- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- j- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit " Master Profesional " në një nga degët e Fakultetit të Inxhinierisë së Mjedisit, Pyjeve
- b- Të kenë të paktën 1 vit përvojë pune në administratën shtetërore vendore;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo pranë Zyres me një Ndalese të Bashkisë Fier, brenda datës **02.12.2025**.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Njësia e burimeve njerëzore të Bashkisë do të shpallë në faqen zyrtare të internetit të institucionit dhe në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit.

1.4. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"
- Ligj nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar
- Ligji nr 57/2020 "Për Pyjet"
- Ligji Nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor " I ndryshuar
- Udhëzim nr 1 date 26.01.2017 "Për mbajtjen e kadastres së fondit pyjor dhe kullosor kombëtar"
- Udhëzim nr. 1, datë 9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik"
- Vendim nr. 438, datë 8.6.2016 "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore"

1.5 . MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar. Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultetit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike "www.dap.gov.al".

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E

KOMUNIKIMIT

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet
- në faqen zyrtare të Bashkisë Fier
- në stenden e informimit publik të Bashkisë Fier.
- Shërbimin kombëtar të punësimit

2. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a- Të jetë shtetas shqiptar;
- b- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit " Master Profesional "
- b- Të kenë të paktën 1 vit përvojë pune në administratën shtetërore vendore;

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip
- b- Fotokopje e notërizuar e diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Letër motivimi;
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- h- Certifikatë e përbërjes familjare;
- i- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhen pranë Zyres me një ndalëse, Bashkia Fier ose nëpërmjet shërbimit postar. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive duhet të bëhet brenda datës **07.12.2025**.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Bashkia Fier do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e

pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligj nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar
- Ligji nr 57/2020 "Për Pyjet"
- Ligji Nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor " I ndryshuar
- Udhëzim nr 1 date 26.01.2017 "Për mbajtjen e kadastres së fondit pyjor dhe kullosor kombëtar"
- Udhëzim nr. 1, datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”
- Vendim nr. 438, datë 8.6.2016 “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Fier do të shpallë fituesin
- në faqen zyrtare të Bashkisë Fier
- në stenden e informimit publik të Bashkisë Fier.
- Sherbimin kombëtar të punësimit